

PLAN STRATEGJIK
2025 -2028
SPITALI RAJONAL KORÇË

Vizioni:

Transformimi në një qendër referimi rajonale e specializuar për një gamë të gjerë shërbimesh cilësore.

Misioni:

Përmirësimi i eksperiencës së pacientit nëpërmjet shërbimeve mjekësore të specializuara, inovative dhe të bazuara në të dhena shkencore aktuale, mundësimi i trajnimeve dhe formimit profesional të stafit.

Vlerat dhe parimet:

Fokusi tek pacienti

Ndershmëri dhe besueshmëri

Integritet dhe profesionalizëm

Punë në grup dhe frymë bashkëpunimi

Përmbajtja

Hyrje

Kapitulli 1: Hartimi i Planit Strategjik.....

Kapitulli 2: Analiza e situatës aktuale.....

- Studime të Planifikimit Strategjik
- Struktura organizative
- Burimet njerëzore
- Burimet financiare
- Analiza e situatës aktuale
- Analiza e palëve të interesuara
- Marrja dhe vlerësimi i opinioneve të palëve të interesuara
- Analiza SWOT
 - Përparësitë
 - Dobësitë
 - Mundësitë
 - Kërcënimet

Kapitulli 3: Planifikimi strategjik.....

- Kategoria e Shërbimit Shëndetësor që ofron spitali
- Misioni, Vizioni dhe parimet tona.
- Qëllimet dhe objektivat strategjike

Kapitulli 4 : Zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi.....

- Parimet e zbatimit
- Monitorimi dhe Vlerësimi

Baza Ligjore

Hyrje

1.Përshkrim të komunitetit/popullatës që i ofrohet kujdes.

Spitali Rajonal Korçë është institucion publik i Ministrisë së Shëndetësisë , jo fitimprurës , i financuar nga Fondi i Detyrueshëm i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor (FDSKSH) . Spitali Rajonal Korçë është person juridik me qendër në Korçë. Spitali është qendër diagnostikimi dhe kurimi i të sëmurëve, shërben si njësi bazë e dhënies së ndihmës mjekësore të specializuar të të sëmurëve të Qarkut Korçë dhe përgjigjet për shërbimin kurativ të kësaj popullate dhe jo vetëm . Jep gjithashtu ndihmën mjekësore emergjente për çdo rast për të gjithë vendin . Spitali shërben edhe si bazë pedagogjike e kërkimeve shkencore për formimin e studentëve të mjekësisë, mjekëve stazhier, infermierëve, laborantëve si dhe kualifikimin e tyre.

• Popullsia ndër vite në Qarkun Korçë.

Popullsia viti 2024 (86,942 meshkuj, 85,562 femra, 172,504 total)
Popullsia viti 2023 (87,238 meshkuj, 85,853 femra ,173,091 total)
Popullsia viti 2022 (97,235 meshkuj, 100,068 femra, 197,303 total)
Popullsia viti 2021 (100,228 meshkuj, 101,965 femra,202,193 total)
Popullsia viti 2020 (101,774 meshkuj, 103,057 femra, 204,831 total)
Popullsia viti 2019 (103,389 meshkuj, 104,500 femra, 207,889 total)
Popullsia viti 2018 (105,080 meshkuj, 105,098 femra, 210,178 total)

Spitali Korçë duke qënë një spital rajonal i ofron kujdes shëndetësor gjithë komunitetit / popullatës së qytetit të Korçës, si dhe si dhe 6 (shtatë) bashkive përbërëse të qarkut Korçë : si Korca, Pogradeci, Maliqi, Bilishti, Erseka, Leskoviku. Qarku i Korçës ka 31 Komuna dhe 344 fshatra. Përveç popullatës së sipër përmendur Spitali Rajonal Korçë duke qënë i vendosur në një nga qytetet turistike me një numur të lartë të turistëve, ofron kujdes shëndetësor dhe për popullsinë jashtë qarkut, si dhe për të huajt që akomodohen në qytetin tonë. Spitali Rajonal Korçë ushtron veprimtarinë dhe përmbush obligimet dhe detyrat e tij në pajtim me normat, standardet, strategjitë dhe politikat e nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë dhe i nënshtrohet mbikqyrjes ligjore dhe profesionale në pajtim me Ligjin për Shëndetësi dhe legjislacionin tjetër në fuqi. Veprimtaria e Spitalit udhëhiqet nga parimi i vlerësimit të shëndetit si një e drejtë e njeriut, e cila garantohet nëpërmjet kujdesit shëndetësor efektiv dhe efikas, te mirëqeverisur dhe që ofron akses të barabartë dhe parimet e solidaritetit, integritetit, transparencës dhe llogaridhënies. Një shoqëri e shëndetshme dhe e mbrojtur nga risqet është synimi ynë madhor sepse, shëndeti është investim për të ardhmen dhe një

ingredient i domosdoshëm për rritjen ekonomike dhe mirëqenien. Bazuar në prirjet demografike ne do të vijojmë të mbështesim fort parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm. Prirjet demografike dhe profili epidemiologjik kërkojnë një trupë profesionistësh të shëndetit me dije dhe aftësi të reja. Nën moton “shëndet për të gjithë” ne promovojmë jetën e shëndetshme, duke bashkërenduar përpjekjet dhe rritur investimet në të gjithë shërbimet që ofron Spitali ynë.

Misioni i këtij spitali është rritja e besueshmërisë së komunitetit, përmirësimi i shërbimit shëndetësor si dhe zhvillimi, vlerësimi dhe përdorimi i teknikave të reja nga një staf me vlera të larta mjekësore dhe shkencore. Përmirësimi i performancës së sistemit shëndetësor drejt arritjes së qëllimeve dhe objektivave është një mekanizëm kryesor i cili do të bëjë të mundur një shërbim më të mirë për qytetarët.

Bazuar në studimin e kryer nga Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Korçë, për popullsinë e rrethit Korçë, gjatë këtij dhjetëvjeçari, arrijmë në vlerësimet si më poshtë :

1. Peshën specifike të shtrimeve spitalore më të lartë e zënë sëmundjet e kardiovaskulare si dhe sëmundjet e aparatit të frymëmarrjes ; Grupmosha me peshën më të lartë të shtrimeve spitalore e zë grupmosha mbi 65 vjeç.
2. Xhiron më të lartë të shtratit në Spitalin Rajonal Korçë e ka Shërbimi Obsetrik, i ndjekur nga Shërbimi i Patologjisë si dhe Reparti i Neurologjisë.
3. Në shtrimet spitalore sipas gjinisë rezulton se meshkuj zënë peshën më të lartë shtrimet nga infakti cerebral vaskulor, helmime dhe aksidente, e ndjekur nga sëmundjet e aparatit të frymëmarrjes ndërsa te femrat janë shtrimet nga kolecistet dhe artriti reumatoid.
4. Në zonat urbane kanë prevalencë sëmundjet kardio-vaskulare e ndjekur nga sëmundjet e aparatit të frymëmarrjes ndërsa në zonat rurale janë traumat e ndryshme dhe traktit gastro-intestinal.
5. Numri i ditëve të qëndrimit mesatar më i lartë në Spitalin Rajonal Korçë është për sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut si dhe sëmundjet endokrine, metabol & turb. Imunitare
6. Gjatë dhjetë viteve të fundit lindshmëria ka pësuar rënie si në qytet edhe në fshat.
7. Vdekshmëria më e lartë është e lidhur me sëmundjet e qarkullimit të gjakut , sëmundje tumorale , sëmundjeve të sistemit nervor qendror dhe organeve të shqisave.
8. Vdekshmëritë neonatale, postnatale dhe infantile shënojnë në rënie të dukshme.

Kërkesat aktuale dhe të së ardhmes së pacientëve .

- 1) Përmirësimi në vazhdim i shëndetit të popullatës nëpërmjet shërbimeve parandaluese, imunizuese dhe ndërgjegjësuere;
- 2) Plotësimi i nevojave të popullatës me shërbime të standarteve bashkëkohore;
- 3) Zhvillimi i mëtejshëm i partneritetit të shërbimit shëndetësor publik/privat me qëllim rritjen e kapaciteteve, si dhe menaxhimi në mënyrë me eficiente i shërbimeve të ofruara në Spital.
- 4) Vendosja e prioritetëve mbi bazën e të dhënave statistikore të Spitalit dhe konsultimi me institucione të tjerë që ofrojnë të dhënat për të arritur në vlerësime të sakta për kërkesat aktuale dhe të së ardhmes së pacientëve.

Përcaktorët e shëndetit dhe mirëqenies.

Të dhënat më të fundit mbi ndikimin e *faktorëve të rrezikut të sëmundshmërisë* në Shqipëri identifikojnë tre faktorë kryesorë të rrezikut për barrën e sëmundshmërisë:

- rreziqet e lidhura me dietën ushqimore;
- hipertensioni arterial;
- duhanpirja.

Gjatë 20 viteve të fundit ka patur një rritje të ndjeshme në barrën e sëmundshmërisë, që i atribuohet *karakteristikave të mënyrës së jetesës* në Shqipëri. Aktualisht, faktorët e stilit të jetesës përbëjnë mbi 70% të barrës totale të sëmundshmërisë.

Arsimi është një tjetër përcaktor i rëndësishëm shoqëror për shëndetin. Korelacioni midis arsimit dhe varfërisë është i zhdrejtë: sa më të arsimuar, aq më pak të varfër janë njerëzit dhe anasjelltas.

Formimi, arsimimi e shprehitë profesionale si dhe arsimimi universitar shërbejnë si nxitës për të hyrë në tregun e punës, për të dalë nga varfëria dhe për të rritur përfshirjen sociale, dhe në perspektivë afatgjatë kontribuojnë në përmirësimin e shëndetit, veçanërisht duke ulur vdekshmërinë neonatale dhe atë amtare.

Mjedis është një nga faktorët kryesorë që influencojnë shëndetin dhe mirëqenien. Evidencat globale dhe rajonale tregojnë që përcaktorët mjedisorë, së bashku me faktorët e stilit të jetës: cilësia e ujit dhe e ajrit, rrezatimet, shëndeti në punë dhe aktiviteti fizik, kanë një ndikim të qenësishëm në shëndetin e popullatës.

Megjithatë, evidencat tregojnë se shëndeti dhe mirëqenia nuk varen vetëm nga performanca e sistemit shëndetësor. Faktorë të tjerë ekonomikë dhe socialë, si të ardhurat, arsimimi, strehimi dhe mjedisi, kanë ndikim të fortë në shëndetin dhe mirëqenien e popullsisë.

Gjatë gjithë periudhës së tranzicionit shqiptarët kanë pasur nivel të ulët të ardhurash. Për më tepër, shpërndarja e pabarabartë e rritjes ekonomike dhe e pasurisë ndërmjet rajoneve ka çuar në rritje të pabarazive në shëndetin e popullatës, veçanërisht midis asaj të zonave urbane e rurale. Këta përcaktorë, të kombinuar me mungesën e aksesit në shërbimet shëndetësore dhe pagesat e mëdha nga xhepi për shërbimet shëndetësore, kanë cënuar shëndetin dhe cilësinë e jetës, veçanërisht për grupet vulnerabël si fëmijët, pensionistët, të pasiguruarit, etj.

2. Raport – Pasqyrë e të dhënave lidhur me profilin e Spitalit Rajonal Korçë nga Zyra e Kartotekës për vitin 2024.

- Nr. i pacientëve të shtruar në vitin – 28.955 pacientë
- Kohë zgjatja mesatare e shtrimit në vitin e shkuar /ditë -2.35
- Numri i shtretërve në spital -510 shtreter
- Mesataren e shfrytëzimit të shtratit në % -29 %
- Numrin e shtretërve në Kujdesin intensive -14 shtretër
- Nurmirin e Pacientëve të shtruar të pranuar si urgjent -17.291 pacientë
- Numri i pacientëve ditor vitin e shkuar – 47.37
- Numrin e kryer të ndë rhyrjeve kirurgjikale – 1.830 ndërhyrje
- Numrin mesatar të trajtimeve preoperatore ditore – 47.37
- Numrin e lindjeve -741 lindje
- Numrin e lindjeve me section –cesarean – 415 lindje
- Mesatarja e qëndrimit në spital/ditë -5.

Kapitulli 1 : Hartimi i Planit Strategjik

Koncepti i strategjisë përfshin mendimin afat gjatë, perceptimin e mire të mjedisit dhe shikimin e qëllimit nëpërputhje me rrethanat. Prandaj, kur flitet për planifikim strategjik, përmenden qëllimet dhe objektivat me një vizion të qartë, të orientuar drejt të ardhmes.

Rajoni në të cilin Spitali Rajonal Korçë ofron shërbime mjekësore të specializuara është padyshim shumë dinamik si në demografi, ashtu edhe në qasjen social-kulturore të popullsisë.

Plani strategjik i hartuar në spitalin tone fokusohet kryesisht në realizimin e disa objektivave bazë që do të shërbejnë si shtylla për ndërtimin e një shërbimi sa më cilësor, të sigurt në kohë ndaj pacientëve. Procesi i zbatimit të menaxhimit strategjik të këtij spitali bëhet në kuadër të reformave të administratës publike dhe menaxhimit të financave publike. Ndër të tjera, ky proces përfshin ndarjen e burimeve sipas prioriteteve strategjike dhe monitorimin e përdorimit efektiv të tyre nëpërmjet raportimit të progresit si dhe llogari dhënies efektive.

Në një anë, ky proces sjell efikasitet në menaxhimin e financave publike, ndërsa në anën tjetër mbështet zhvillimin dhe forcimin e kulturës dhe identitetit të administratave publike.

Plani strategjik është një udhërrëfyes që siguron përmbushjen e objektivave afat gjatë nëpërmjet plotësimit hap pas hapi të qëllimeve afat shkurtra. Bordi drejtues i spitalit, administratori përgjithshëm, ekipi i menaxhimit teknik dhe ekonomik si dhe stafi i këtij spitali kanë një qasje pozitive ndaj realizimit të objektivave të këtij plani, si e vetmja rrugë drejt transformimit në një qendër rajonale spitalore të specializuar, e cila do të shërbejë si pikë referimi për një gamë të gjërë shërbimesh mjekësore diagnostifikuese dhe kuruese në rajon e mbase dhe me gjerë.

Hartimi i Planit Strategjik

Menjëherë pasi u krijua ekipi i hartimit të planit strategjik 2023-2026, u fillua me krijimin e një axhende takimesh me palë të interesit dhe me stafin e Spitalit Rajonal Korçë . Qëllimi i këtyre takimeve ishte mbledhja e mendimeve dhe përvojave të secilit pjesëmarrës si dhe krijimi i një kulture organizative për të siguruar qëndrueshmëri në vendime të mëtejshme. Bota po ndryshon, vendi ynë po ndryshon dhe ne po ndryshojnë. Prandaj, besuam se ishte e nevojshme të jemi pro aktivë dhe të planifikojmë një rrugëtim të sigurt përpara në menaxhimin strategjik të spitalit. Për të hartuar planin strategjik të spitalit jemi bazuar në Planin Strategjik për Shëndetësinë 2021- 2030 si dhe në politikat strategjike të MSHMS të administruara dhe zbatuar nëpërmjet institucioneve rajonale në varësi të saj.

Gjatë procesit të planifikimit janë analizuar dhe vlerësuar nevojat e kujdesit shëndetësor të komunitetit të cilit i ofrojmë shërbimet tona. Si rezultat i kësaj analize kemi përcaktuar qëllimet kryesore dhe pas analizimit të faktoreve të brendshëm dhe të jashtëm ndikues, i kemi zbërthyer ato në objektiva konkrete, realizimi i të cilëve do të matet me indikatore performance specifike.

Mesazhi i Spitalit Rajonal Korçë

Spitali Rajonal Korçë ushtron veprimtarinë dhe përmbush obligimet dhe detyrat e tij në pajtim me normat, standardet, strategjitë dhe politikat e nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë dhe i nënshtrohet mbikqyrjes ligjore dhe profesionale në pajtim me Ligjin për Shëndetësi dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Veprimtaria e Spitalit si dhe Plani ynë Strategjik udhëhiqen nga parimi i vlerësimit të shëndetit si një e drejtë e njeriut, e cila garantohet nëpërmjet kujdesit shëndetësor efektiv dhe efikas, te mirëqeverisur dhe që ofron akses të barabartë dhe parimet e solidaritetit, integritetit, transparencës dhe llogaridhënies.

Vlerat thelbësore të sistemit shëndetësor burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe angazhimet kombëtare ndaj standardeve ndërkombëtare e rajonale të të drejtave të njeriut. Ato janë:

Universaliteti

Qëndrueshmëria

Cilësia

Përballueshmëria

Përkushtimi ndaj shëndetit si një e drejtë njerëzore dhe e mirë publike

Inovacioni

Integriteti

Efikasiteti

Transparenca

Llogaridhënia

Dinjiteti

Një shoqëri e shëndetshme dhe e mbrojtur nga rrisqet është synimi ynë madhor sepse, shëndeti është investim për të ardhmen dhe një ingredient i domosdoshëm për rritjen ekonomike dhe mirëqenien. Bazuar në prirjet demografike ne do të vijojmë të mbështesim fort parandalimin dhe diagnostikimin e hershëm.

Prirjet demografike dhe profili epidemiologjik kërkojnë një trupë profesionistësh të shëndetit me dije dhe aftësi të reja. Paralelisht me plotësimin e boshllëqeve të krijuara në vite për specialistë të kujdesit shëndetësor, Strategjia garanton rivendosjen e autoritetit dhe dinjetit të profesionistit të shëndetësisë duke nxitur dhe siguruar ngritjen e vazhdueshme të cilësisë dhe performances së shërbimeve spitalore.

Nën moton “shëndet për të gjithë” ne promovojmë jetën e shëndetshme, duke bashkërenduar përpjekjet dhe rritur investimet në të gjithë shërbimet që ofron Spitali ynë.

Prirjet demografike krijojnë një profil të ri epidemiologjik, prandaj Strategjia parashikon që sistemi i kujdesit shëndetësor të japë përgjigjet e duhura.

Misioni i Spitalit Rajonal Korçë

Misioni i këtij spitali është rritja e besueshmërisë së komunitetit, përmirësimi i shërbimit shëndetësor si dhe zhvillimi, vlerësimi dhe përdorimi i teknikave të reja nga një staf me vlera të larta mjekësore dhe shkencore.

Spitali Rajonal Korçë ka për mision zbatimin e politikave dhe strategjive të zhvillimit në sistemin shëndetësor të miratuara nga Mnistria e Shëndetësisë.

Përmirësimi i performancës së sistemit shëndetësor drejt arritjes së qëllimeve dhe objektivave është një mekanizëm kryesor i cili do të bëjë të mundur një shërbim më të mirë për qytetarët.

Qëllimi i hartimit të Planit Strategjik

Plani strategjik 2025 “Për veprimtarinë e Spitalit Rajonal Korçë”, ka si qëllim përcaktimin e drejtimeve kryesore të zhvillimit të Spitalit identifikimin e sistemeve/fushave me nivel të lartë risku, si dhe përcakton punën që do të ndërmerret nga ana Drejtorisë për vitet në vazhdim.

Objektiva Strategjike

Rritja e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore për qytetarët;

Përmirësimi i infrastrukturës ndërtimore si dhe ofrimi i shërbimit mjekësor përmes aparaturave e paisjeve bashkëkohore;

Proçesimi më i shpejtë i procedurave regjistrim, pranim, shërbim shëndetësor, dalje me qëllim garantimin e aksesit të shpejtë dhe cilësor tek shërbimet spitalore ;

Zbatimi i sistemit të referimit në identifikimin, regjistrimin dhe levizjen e pacientit brenda spitalit;

Monitorimi i zbatimit të rregullave të Sistemit të Referimit dhe ndergjegjesimi i drejtperdrejte i popullatës dhe personelit mjekësor për zbatimin e rregullave të Sistemit të Referimit ;

Reduktim i nivelit të vdekshmërisë nga Infarkti Akut i Miokardit (IAM), brenda 24 orëve të para të shtrimit;

Reduktim i nivelit të vdekshmërisë foshnjore perinatale;

Reduktimi i numrit të lindjeve me sexio-cesariane;

Reduktim i nivelit të vdekshmërisë në shërbimin e urgjencës;

Reduktimi i transferimeve të pacienteve në spitalet terciare;

Përdorimi i kontrolluar i antibiotikëve në tërësi;

Minimizimi i infeksioneve spitalore;

Përmirësimi i kostos dhe efikasitetit;

Planifikim buxhetor më i saktë, që i përgjigjet nevojave reale;

Përmirësimi i planifikimit buxhetor për parashikimin e nevojave për medikamente;

Menaxhim më i mirë spitalor përmes teknologjisë së informacionit (sistemeve të informacionit):

Statistika të gjeneruara në kohë reale;

Kontroll i saktë i qarkullimit të çdo pacienti e medikamenti;

Unifikim i të dhënave për përmirësimin e procesit klinik dhe organizimin efikas të fluksit të informacionit;

Përmirësimi i menaxhimit klinik përmes zbatimit dhe azhornimit të protokolleve klinike ;

Mbështetja e kërkimit mjekësor/klinik sipas standardeve të kohës;

Nxitja e etikës dhe vlerave brenda Institucionit;

Komunikimi efektiv i informacioneve për riskun dhe kontrollin për fushat e duhura të njësisë.

Sigurim i mirëmenaxhimit, integritetit, transparencës dhe aksesit në shërbimet shëndetsore, me mbështetjen e partneritetit llogaridhënës publik-privat dhe modeleve të tjera për mobilizimin e burimeve shtesë për shëndetin;..

Rritja e profesionalizmit të stafit administrativ dhe spitalor;

Specializim dhe trajnim të stafit në mënyrë të vazhdueshme ;

Rritja e ndjenjës së përgjegjësisë dhe e profesionalizmit në kryerjen e detyrës nga ana e stafit spitalor si pasojë e evidentimit të çdo veprimi brenda sistemit;

Ndarja e përgjegjësisë të secilit segment të zinxhirit të veprimeve;

Rritja e përgjegjshmërisë, performancës dhe transparencës përmes monitorimit të vazhdueshëm ;

Thjeshtëzimi i proceseve rutinë dhe përmirësimi i rezultateve në punë;

Kapitulli 2: Analiza e situatës aktuale

Studimet e planifikimit strategjik

Studimet e para për planifikimin strategjik filluan me krijimin e grupit të punës për hartimin e Planit Strategjik 2025-2028, ose “Ekipi i Planifikimit Strategjik”. Anëtarët e ekipit u zgjodhën duke marrë parasysh përfaqësimin e të gjitha njësive strategjike të spitalit, pranimin e vlerave dhe parimeve të ekipit, frymën bashkëpunuese, produktive të tij dhe kompetencën.

Proçesi i planifikimit strategjik

Bazuar në pyetjen se kush jemi ne, do të përcaktohet statusi aktual dhe statusi i synuar i spitalit.

Mendimet dhe sugjerimet e të gjithë stafit të spitalit duhet të vlerësohen duke informuar ekipin e planifikimit strategjik përmes të gjitha formave të komunikimit të punonjesve të spitalit.

Gjatë punës, u kushtua vëmendje e vecantë takimeve të rregullta, pjesëmarrjes aktive të palëve të interesuara dhe diskutimit të komenteve. Plani Strategjik i Ministrisë së Shëndetësisë u pranua si dokument bazë.

Për përcaktimin e vizionit, misionit, qëllimit dhe objektivave, u përdorën metoda nga literatura vendase dhe ndërkombëtare si dhe teknikat “Common Mind”. Gjatë gjithë procesit, u realizuan disa tavolina të rumbullakëta me drejtorinë e Spitalit që konsistuan në shkëmbime idesh, mendimesh dhe raportime të ecursisë së hartimit të planit strategjik.

Në studimet e planifikimit strategjik, fillimisht kemi analizuar situatën aktuale. Bazuar në rezultatet e analizës së situatës aktuale dhe analizën e palëve të interesuara, kemi identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, mundësitë dhe kërcënimet për spitalin. Gjithashtu kemi përcaktuar aktorët e brendshëm dhe të jashtëm që kanë rol në zhvillimin e spitalit dhe u kemi drejtuar atyre pyetje në takimet me to.

Pjesë e analizës së brëndshme ishin pyetësorët e realizuar me Pacientët e Hospitalizuar dhe ato Ambulator. Gjithashtu u realizuan Pyetësorë për punonjësit e administratës së spitalit si dhe për personelin mjekësor.

Në dritën e të gjitha këtyre të dhënave, kemi zhvilluar studime të vizionit dhe misionit me anëtarë të ekipit tonë. Në këtë proçes kemi shqyrtuar vizionin dhe shembuj të misionit të institucioneve dhe organizatave private dhe publike. Sipas studimeve tona, kemi përcaktuar vizionin dhe misionin e spitalit tonë, dhe kemi vendosur pritshmëritë tona për të ardhmen e spitalit. Së bashku me vizionin dhe misionin e përcaktuar, kemi përcaktuar objektivat, duke u bazuar në analizën e situatës aktuale, analizat e palëve të interesuara të brendshme dhe të jashtme, reagimet, mendimet dhe bisedat me anëtarë të ekipit tonë.

STRUKTURA E SPITALIT RAJONAL KORÇË

DREJTORI

ZVËNDËSDREJTOR (SHËRBIMET KLINIKE) KRYEINFERMIER

Shërbimi i Urgjencës

Shërbimi i Patologjisë

Shërbimi i Kardiologjisë

Shërbimi i Kirurgjisë

Shërbimi i Anestezi-Reanimacionit

Shërbimi i Pediatriisë

Shërbimi i Obstetrikë-Gjinekologjisë

Shërbimi i Neonatologjisë

Shërbimi i Neurologjisë

Shërbimi i Pneumoftiziatrisë dhe
Dispanseria Anti TBC

Shërbimi i Farmacisë

Shërbimi i Imazherisë

Morgu

Banka e Gjakut

Shërbimi i Poliklinikës

ZËVËNDESDREJTOR (SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE)

Spektori i Kujdesit dhe Koordinimit me
Pacientët

Spektori i Çështjeve Ligjore dhe
Auditimit

Spektori i Financës

Spektori i Planifikimeve dhe Prokurimeve

Spektori i Burimeve Njerëzore

Spektori i Menaxhimit të Teknologjisë

Spektori Teknik

Spektori i Hotelerisë

Spektori i Shërbimeve Mjedisore

Shërbimet që ofron Spitali Rajonal Korçë-Burimet Njerëzore

A - Shërbimet me shtretër :

1. Shërbimi Pranim-Urgjencës(me shtreter ditor).
- 2.Shërbimi i Kirurgjisë (kirurgjia e pergjithshme, ORL – Okulistika dhe Salla e Operacionit).
3. Shërbimi i Terapise Intensive (i perfshire ne sherbime)
4. Shërbimi i Kardiologjisë
5. Shërbimi i Patologjisë
6. Shërbimi i Imazherisë
- 7.Shërbimi i Pediatrie (Pediatria e pergjithshme, pediatria infektive, reanimacioni i pediatrie,urgjenca pediatrike).
- 8.Shërbimi i Obstetrikë – Gjinekologjisë Materniteti (Obstetrika, Gjinekologjia, , Salla e Operacionit).
9. Shërbimi i Neonatologjisë
- 10.Shërbimi i Pneumoftiziatrisë dhe Dispancerisë
- 11.Shërbimi i Neuropsikiatrisë

B - Shërbimet ndihmëse të përbashketa (komplementare).

Shërbimi Farmaceutik

Shërbimi i Recepsionit(operatorët)

Banka e Gjakut.

C - Shërbimi i Poliklinikës (*Poliklinika e Specialiteteve*).

Kabineti i Imazherisë

Kabineti i Kardiologjisë

Kabineti i Neurologjisë

Kabineti i Psikiatrisë

Kabineti Onkologjisë

Kabineti i Urologjisë

Kabineti i Kirurgjisë

Kabineti i ORL

Kabineti i Okulistikës

Kabineti i Endokrinologjisë

Kabineti i Ortopedisë

Kabineti i Alergologjisë

Kabineti i Nefrologjisë

Kabineti i Gastroentereologjisë

Kabineti i Reumatologjisë

Kabineti i Sëmundjeve Profesionale

Kabineti i Dermatologjisë

Kabineti i Hematologjisë

Kabineti i Neuropediatriisë

Burimet financiare

Në formë tabelare, buxhetimi, referuar projekt buxhetit si dhe financimit të një viti më pare paraqitet :

Emërtimi i Shpenzimit	Viti 2023	Projekt Buxheti	Financimi 2024	Kundrejt 2023	Kundrejt PB
Paga dheshperblime 600	490231000	575408000	560827000	114.40%	97.46%
Sig.Shoqeroreshendetesore 601	80801576	96098000	92310000	114.24%	96.06%
Shpenzime operative 602	374000000	405000000	399000000	106.68%	98.52%
Investime 231	0	0	0	0%	0.00%
Totali	945032576	1076506000	1052137000	111.33%	97.73%

Realizimi i treguesve ekonomike të buxhetit, për vitin 2024, në formë tabelare paraqitet si më poshtë :

EmërtimiiShpenzimit	Plani 2024	Faktiviti 2024	% e realizimit
Paga dheshperblime 600	559544895	559544405	100 %
Sig.Shoqeroreshendetesore 601	92310000	92309200	99.999 %
Shpenzime operative 602	315000000	315000000	100 %
Sherbim laboratory 602	84500000	84500000	100 %
Shperblim pensioni 606	1282105	1282105	100 %
	1 052 637 000	1 052 635 710	99.999 %

Analiza SWOT

Spitali ka identifikuar elementët e mëposhtëm si elementë që mund të influencojnë në performancën e viteve të ardhshme.

Pikat e forta

Pikat e forta	Impakti strategjik
Aksesueshmeria	Kohe e ulët pritje për konsultë apo shërbime pa prenotim
Personel mjekësor me aftësi të larta profesionale	Diagnostikim në kohë dhe me saktësi, trajtim me i shpejte I përshtatshëm për rastin
Numër i lartë mjekësh specialistë	Kohë pritje më e ulët për pacientin
Gamë e gjërë shërbimesh të specializuara	Konkurencë e lartë në rajon Mbyllje e ciklit Diagnostikim-Trajtim-Ndjekje brenda të Shërbim 24
Shërbim 24 ore/7ditë me mjekë specialist oncall	Shërbim i specializuar në rastet më call komplekse, edhe jashtë orarit zyrtar të konsultave Më pak pacientë të transferuar në qendrat terciale

Pikat e dobëta

Pikat e dobëta	Impakti Strategjik
Sistem manual regjistrimi të dhënash/dokumentesh dhe kartelizim manual	Ineficencë Pritje të gjata në reception Paqartësi të dhënash nga shkrimi i dorës
Veshtirësi e stafipër t'u përshtatur me risitë dhe përditësimet e vazhdueshme në informatikë	Trajnime inefficente Vonesa në zbatimin e projektit të dixhitalizimit
Mungesa e mbështetjes teknike në sisteme të informatizimit	Vonesa në zbatimin e projektit të dixhitalizimit/informatizimit në spital
Fluks i lartë konsultash në Urgjencë	Personel i lodhur, I pakënaqur Shërbim me performancë më të ulët

	Numër i lartë hospitalizimi nga urgjenca
Madhesia fizike e spitalit tonë, hapësra e konceptuar për me pak shërbime	Grumbullime të papërshtatshme të pacientëve në pritje për konsulta
Mungesa e numrit të mjekëve në disa degë	Personel i lodhur/i pa kenaqur me shërbime të shpeshta 24 orëshe.
Mungesa e një stemi ngohje/ftohje qendrore	UI kënaqshmërinë e pacientit Rrit konsumin e energjisë elektrike
Pikat e dobëta	Impakti Strategjik
Aparatura me shumë vite në funksion	Ulet efienca dhe shpejtësia e realizimit të ekzaminimeve Rritet koha e pritjes për ekzaminime Performancë joadekuate në diagnostikim
Shpërndarje joadekuate e shërbimeve në shtreterve në shërbime.	Mosplotësim të indikatorëve të performancës sipas shërbimeve Mbingarkesë në disa shërbime dhe inefficence në shërbime të tjera Mbingarkesë e pabarabartë në punën e personelit infermieror dhe ndihmës në disa shërbime

Mundësitë

Mundësitë	Impakti strategjik
Spital Rajonal me numër të madh shërbimesh të specializuara	Konkurrencë me spitalet rajonale në Rajon Mundësi për tu transformuar në një Qendër Rajonale të Specializuar
Mbështetja në politikat e MSHMS për referimin rajonal të pacientëve	Numër i lartë pacientësh që marrin shërbim eficient Rritje e treguesve të performancës spitalore
Partneritete strategjike	Më shumë mundësi financimi Transferim dhe shkëmbim experience Praktikë klinike e përmirësuar
Projektet e MSh; RHIS	Shkurtime të proceduarve manual Dokumentim i saktë dhe i shpejtë i aksesueshëm kurdo I të dhënave të pacientit që ka marrë shërbime
Projekti I rikonstruksionit të Poliklinikes	Ulje e fluksit të referimeve në spital për rastet ambulatorë Rritje e cilësisë së shërbimit për pacientët në ambiente më komode për pritje dhe konsultim Mundësi e pajisjes me aparatura të reja mjekësore më efiente

Risqet

Risqet	Impakti Strategjik
Fatkeqesitë natyrore	Largojnë fokusin nga shërbimet e specializuara dhe kontrollet rutinë Konsumojnë burime financiare dhe njerëzore
Lëvizshmëria e stafit-kryesisht infermierë	Stafet e reja pa eksperiencë pune në shërbime me ngarkesë dhe kompleksitet të lartë pacientësh.
Rritje e numrit të pacientëve ne nevojë për shërbim të zgjatur spitalor	Kosto të larta të shërbimit Kërkese për personel shtesë të specializuar
Rritje e numrit të spitaleve / Klinikave private	Ulje e numrit të pacientëve Konkurrencë
Rritje e numrit të proceseve gjyqësore	Rritje e kostove financiare Dëmtohet imazhi

Analiza e palëve te interesuara

Pala e interesuar	Cfarë presin nga SRK	Cfarë pret SRK	Ndikimi
Pacientët	Shërbim cilësor dhe në kohë Përkujdesje profesionale Konfidencialitet Respekt	Respekt për stafin Kompliancë me Diagnozën dhe trajtimin	I lartë
Studentët (UNIKO)	Tajnime cilësore Akses në ambjentet e praktikës	Zbatimi i rregullave te spitalit Korrektesi në praktikën e punës.	I lartë
Vizitoret	Informacion të qartë	Respektim i orarit të vizitave	Mesatar
Spitalet e tjera	Bashkëpunim profesional Informim mbi rastet e referuara	Zbatimin i rregullave Bashkepunim	I lartë
Ministria e shëndetësisë	Zbatimi i politikave dhe raportim në kohë Zbatim i planeve dhe rregullave Ekzekutim i urdhërave dhe udhëzimeve Perdorim i rregullt dhe eficient i burimeve financiare	Orientim për zbatimin e politikave Mbështetje me investimet e duhura Sigurim i burimeve financiare për të ofruar shërbime cilësore Koordinim i punës me Institucionet Rajonale	I lartë

		Shëndetësore	
Institucionet Shëndetësore Rajonale (Drejtori Rajonale OSHKSH) (Drejtori Rajonale FSDKSH)	Zbatim i dispozitave të kontratës në fuqi. Raportim i sakte dhe në kohë i pasqyrave sipas kontratës	Koordinim ndërmjet institucioneve për zbatimin e politikave të MSH Mbështetje në plotësimin e nevojave financiare	I lartë
	Përdorim i duhur i burimeve financiare	Për paketat eofruara ndaj pacientit. Mbështetje në rekrutimin në kohë të personelit mjekësor dhe infermieror sipas akteve ligjore në fuqi	
Stafi mjekësor	Ambjent i përshtatshëm pune Vlerësim nga drejtuesit Trajnime periodike	Respektim i orarit dhe etikes se punes Sherbim në nivele të larta profesionale për pacientet	I lartë
Administrata	Ambjent përshtatshëm pune Vlerësim nga drejtuesit Trajnime periodike	Respektim i orarit dhe etikës së punës Eficence dhe plotësim i detyrave funksionale	I lartë

Palët e interesuara janë individë, grupet ose institucionet që kanë lidhje me produktet dhe shërbimet e spitalit tonë dhe që ndikohen drejt përdrejt ose tërthorazi nga veprimtaritë e spitalit, apo që ndikojnë në institucionin tonë.

Aktorët e brendshëm:

Këtu përfshihen individët, grupet ose departamentet brenda organizatës që preken ose ndikojnë në funksionimin e saj. Punonjësit e spitalit dhe stafi administrativ janë shembuj të qartë të palëve të interesuara të brendshme. Gjithashtu aktorët e brendshëm janë të gjithë institucionet që me politikat e tyre ndërhyjnë si rregullator apo vendimmarrës në procesin e mirë funksionimit të spitalit.

Aktorët e jashtëm:

Këtu përfshihen individët, grupet ose institucionet që janë jashtë institucionit tonë, por kanë ndikim ose preken nga veprimtaritë tona. Organizatat e tjera në sektorin publik dhe privat që kanë lidhje me aktivitetet e spitalit, sindikatat, shoqatat përkatëse, janë disa shembuj të palëve të interesuara të jashtme.

Në përcaktimin e prioriteteve të palëve të interesuara, është marrë parasysh fuqia e palës së interesuar për të ndikuar në aktivitetet e institucionit dhe shkallën e dikimit në aktivitetet e institucionit. Metoda e pyetësorit dhe intervistës ballë për ballë janë përdorur për të marrë opinione të palëve të interesuara. Në vlerësimin e opinioneve është përdorur metoda Microsoft Excel dhe për disa pyetje janë realizuar pyetësorë të përshtatshëm

Kapitulli 3 : Planifikimi strategjik

Spitali i Korçës ofron shërbime në specialitetet të një game të gjerë.

Shërbim ku kryhen praktika mësimore në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave të Natyrës.

Spitali është pjesë e sistemit të referimit rajonal-në nivel qarku.

Më poshtë paraqiten në tabelë qëllimet kryesore të zbërthyer në objektiva për tu arritur mundësisht brënda afatit të zbatimit të këtij plani strategjik, si dhe një pasqyrë e thjeshtë e indikatorëve që do të shërbejnë si matës të plotësimit / progresit të tyre.

Qëllimi	Objektivi	Aktivitetet	Treguesit e performancës
Qëllimi 1: Përmirësimi i cilësisë operacionale përmes përdorimit të praktikave të mira në menaxhimin, rritja e nivelit të kënaqësisë për pacientin dhe profesionistë të kujdesit shëndetësor.	1. Të sigurojë qëndrueshmërinë e burimeve njerëzore dhe të vazhdojë të përmirësojë planifikimin e tij	Trajnime për punonjësit. Planifikimi burimeve njerëzore të nevojshme për të ofruar shërbim eficient Vlerësime të performancës për punonjësit në fushën shëndetësore.	Numri i punonjësve të trajnuar Raportet e performancës
	2. Përmirësimi i performancës së profesionistëve shëndetësor	Monitorimi kënaqësisë së personelit Aktivitet për të rritur ndjenjën e kënaqësisë së punonjësve Trajnime komunikimi për personelin shëndetësor Analizë buxhetore/vendime Për të hapur mensën për personelin	Monitorimi i normave të anketeve 2x në vit Trajnim mbi komunikimin 1x në vit Hapja e mensës brënda afatit të caktuar pas analizës buxhetore Aktivitet social/certifikata mirënjohje
	3. Rritja e kënaqësisë së pacientit	Trajnime të komunikimit Për personelin në kontakt me pacientin	Rritja e indeksit të kënaqshmërisë së pacientit

Qëllimi 2			
		Anketim periodik i pacientëve që marrin shërbim në lidhje me cilësinë e shërbimit të marrë. Hapja e postacionit/kuti për ankesat dhe ngritja e një komisioni për shqyrtimin e tyre.	% e lartë e zgjidhjes së konflikteve/ankesave nga pacientët
	5: Optimizimi trajtimeve npr endoskopisë/laparoskopisë në shërbimin e kirurgjisë deri në fund të vitit 2026	• Të optimizohen aparaturat endoskopike/laparoskopike ekzistuese • Analize financiare për të siguruar blerjen e aparaturave të reja • Trajnim i personelit mjekësor me qëllim sigurimin në rutinën kirurgjikale të trajtimeve sa më pak invazive.	• Rritja me 30% e numrit të ndërhyrjeve kirurgjikale me endoskopi/laparoskopi • Rritja e treguesve të aktivitetit spitalor
	6: Optimizimi i funksionimit të klinikës së Neonatologjisë deri në fund të vitit 2026	• Informimi dhe trajnimi për Personelin shëndetësor. • Analiza financiare për të siguruar blerjen e pajisjeve të ndryshme • Krijimi i moduleve të trajnimit për nënat e reja	• Rritja e treguesve të Aktivitetit spitalor • Rritje e numrit të nënave të trajnuara/vit
	7: Rritja e gamës së shërbimeve në shërbimin e gjinekologji obstetrikës deri në fund të vitit 2026	• Pajisja me endoskop (histeroskop) për qëllime diagnostikuese dhe intervencionale • Trajnimi i personelit mjekësor dhe infermieror për përvetësimin e njohurive për përdorimin e endoskopit/histeroskopit • Analize financiare për të siguruar blerjen e aparaturave të reja	• Rritje 30% e treguesve të Aktivitetit spitalor • Rritja me 50% e numrit të ekzaminimeve për ndërhyrje endoskopike
	8: Optimizimi i Shërbimit të Anestezi-Reanimacionit	Analizë buxhetore për të siguruar mbështetjen financiare për optimizimin e aparaturave ekzistuese dhe blerjen e aparaturave të reja Trajnim i stafit infermieror	Ulja e ditë-qëndrimit për pacient Rritja e numrit të pjesëmarrësve në trajnime Rritje e treguesve të cilësisë së shërbimit

Zbatimi i një modeli të integruar të shërbimit shëndetësor dhe përmirësimi i shërbimeve të ofruara	1. Hapja e klinikës së Onkologjisë me shtretër që shërben 24 ore deri në fund të vitit 2026.	Krijimi i ekipeve të specializuara për të ofruar shërbim cilësor Pyetësor për identifikimin dhe plotësimin e nevojave të inxhëve dhe personclit të angazhuar në këtë njësi.	Funksionimi aktiv i njësisë së shërbimit të Onkologjisë me 8 shtretër në baza 24-orëshe Përmirësimi i treguesve të performancës
	2: Hapja e shërbimit të poliklinikës të rikonstruktuar deri në fund të vitit 2023 e optimizuar me të gjitha specialitetet ambulatorë	Organizimi i dhomave Ambulatore në mënyrë eficiente Organizimi i orarit të konsultave dhe planit të mjekëve me rrotacion në këtë shërbim Sigurimi i aparaturave të nevojshme për ofrimin e një shërbimi kompleks dhe Të integruar	Hapja e poliklinikës Rritja e treguesve të aktivitetit të konsultave dhe ekzaminimeve ambulatorë të kryera
	3: Futja në funksion 24 orë e shërbimit të hemodinamikes gradualisht deri në fund të vitit 2026	Trajnime për stafin infirmieror Trajnime dhe shkëmbime profesionale për mjekët hemodinamist për të rritur shumëllojshmërinë e	Rritja e numrit të Infermierëve të trajnuar Ulja e numrit të pacientëve të transferuar në QSUT me 50%

		Procedurave të kryera.	
	4: Hapja e njësive të terapisë subintensive në Patologji, Pneumologji dhe Neurologji dhe optimizimi i njësive ekzistuese në Pediatri dhe Neonatologji deri në fund të vitit 2026.	• Analizë buxhetore dhe llogaritje e kostos së nevojshme për sigurimin e aparaturave të nevojshme • Përcaktimi i kushteve fizike të nevojshme dhe nevojat e personelit për të siguruar funksionimin e mirëfilltë të njësive subintensive.	Hapja e të paktën një Njësie trajtimi subintensive në 3 klinika. Ulja e numrit të transferimeve nga këto shërbime në reanimacion Përmirësimi i treguesve të aktivitetit spitalor për këto shërbime

Qëllimi 3			
Rritja e besueshmërisë së spitalit dhe siguri e lartë për pacientin	1: Minimizimi i sëmundjeve të rëjtë deri në fund të vitit 2026	•Trajnime për Profesioniste te kujdesit shëndetësor •Infermierët e kontrollit të infeksionit •Siguria mjedisin dhe materialet e nevojshme •Mase efektiviteti i trajnimeve •Ofrimi i trajnimeve të personalizuar kur eshte e nevojshme	Ulja e shkallës së Infeksionit spitalor Rritja e rasteve të raportuara formalisht nrm formularit përkatës
	2:Forcimi i shërbimeve shëndetësore në raste emergjente	•Trajnimi për raste emergjente për të gjithë personelin - Identifikimi dhe kontrolli i Rreziqeve të ndërtesës •Identifikimi i rreziqeve të bazuara në njësi dhe analiza e rrezikut	Masat paraprakedhë trajnimeve e nevojshme kundërfatkeqësive dhe situatave të jashtëzakonshme
Qëllimi 4			
Sigurimi i shërbimeve klinike të aksesueshme, efektive dhe me cilësi të lartë.	I:Rritje e monitorimit te shërbimit eficient	•Audite klinike periodike •Në bashkpunim me Komisionin Mjekësor-Hartim i formularit të deklarimit të gabimeve mjekësore. •Analizë e gabimeve Mjekësore të deklaruara	Reduktim i numrit të Gabimeve mjekësore •Reduktimiditë-qëndriirit

	2: Përmirësimi i infrastrukturës dhe paisjeve	Hartimi i një plani Monitorimi dhe vlerësimi periodik të gjëndjes teknike të aparaturave mjekësore Planifikim i nevojave për aparatura te reja	•realizimi i vlerësimit të paisjeve-raport teknik • % e aparaturave të optimizuara/të reja
	3:Përmirësimi i cilësisë klinike të shërbimeve	• Analiza vjetore e treguesve klinikë të cilësisë. • Organizimi i trajnimeve Për përmirësimin e cilësisë klinike dhe shpërndarja e praktikave të mira Zhvillimi/Zbatimi i Protokolleve të Praktikës Klinike Auditim mbi zbatimin e Procedurave Standarde Operacionale	•Përmirësimi shfrytëzimit të shtratit • Ulje e mortalitetit Rritje e xhiros së shtratit • Ulje e ditë-qëndrimit mesatar
Qëllimi 5			
Të jemi një Spital që përdor aplikime teknologjike për shërbimet shëndetësore në mënyrë efektive dhe korrekte	1: Transformimi drejt dixhitalizimit per te siguruar shërbim te mire,rritui-eksperiencë ne stafit, uljen e kostove dhe optimizimin e proceseve operacionale	• Zbatimi i trajnimeve të Përcaktuar si pas moduleve (RHIS). • Përdorimi i sistemit digital për te gjitha shërbimet • Ofrimi i vazhdueshem per punonjësit per te siguruar kompetencën e tyre ne perdorimin e pajisjeve injekesore dhe Teknologjisë dixhitale	• Norma e realizimit të këtyre hapave dhe përdorimit të sistemeve teknologjike. • Pjesinarrje e lartë ne trajnime • Përvetësimi i njohurive nga ana e punonje.sve

Kapitulli 4 : Zbatimi , monitorimi dhe vlerësimi

Parimet

Parimet e zbatimit të Planit Strategjik të Spitalit Korçë janë si vijon:

Plani strategjik i përgatitur përfshin vitet 2025-2028.

Zbatimi efektiv i planit strategjik është përgjegjësia e të gjitha njësive dhe punonjësve në bashkëpunim me drejtuesit e spitalit.

Ndryshimet në ekipin e planifikimit strategjik nuk kanë ndikim në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e planit strategjik.

Zbatimi i planit strategjik bazohet në vazhdimësi dhe bashkëpunim ndërmjet njësive dhe punonjësve.

Plani strategjik rishikohet në varësi të ndryshimeve institucionale dhe mjedisore.

Monitorimi dhe vlerësimi

Monitorimi është procesi sistematik i ndjekjes dhe raportimit të zbatimit të planit strategjik, ndërsa vlerësimi është matja e rezultateve të zbatimit në krahasim me qëllimet dhe objektivat, duke analizuar konsistencën dhe rëndësinë e tyre.

Përgjegjësia për këtë proces i takon Ekipit të Planit Strategjik. Aktivitetet strategjike do të monitorohen, vlerësohen dhe raportohen nga Ekipi i Planifikimit Strategjik nga njësitë përgjegjëse për arritjen e objektivave të përcaktuara në kuadër të planit strategjik. Në rastet kur qëllimet dhe objektiva të planifikuara nuk mund të arrihen sipas rezultateve të vlerësimit, do të analizohen arsyet dhe do të ndërmerren veprimet e nevojshme e korrigjuese dhe parandaluese. Plani strategjik i përgatitur do të rishikohet nga ekipi në fund të çdo viti dhe do të rishikohet kur të jetë e nevojshme.

Përmbledhje e arritjeve kryesore organizative .

Për vitin 2024 Spitali Korçë nuk ka patur asnjë financim të drejtpërdrejtë, por pritet rikonstruksioni i plotë i godinës . Janë kryer investime me vlerë të konsiderueshme, drejtpërdrejt nga ana e Ministrisë në vitet e mëparshme ku vlen të përmendet:

F.v. i pajisjes së Scaner me vlerë rreth 55 milion lekë ,e cila mundësoi ofrimin e një shërbimi cilësor për banorët e qarkut të Korçës.

Fuqizimi i gamës së aparaturave mjekësore me aparaturën DEXA për matjen e densitometrisë kockore, në vlerën 3 540 000 lekë.

Fuqizimi i flotës së automjeteve me 1 autoambulancë të re, prodhim i vitit të fundit të kompletuar me të gjithë pajisjet mjekësore të domosdoshme me vlerë 8 934 000 lekë.

Sistemi i patronazhimit nga spitalet universitare nga muaji janar përmes planit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në vazhdimësi është përmirësuar sistemi i qarkullimit të pacientëve sipas sistemit të referimit, qarkullimi i personelit brenda spitalit, vendosja dhe respektimi i orarit të vizitorëve.

Spitali ka siguruar gjithmonë veshje të përshtatshme për infermierë dhe sanitarë.

Sistemi i rekomandimeve elektronike në poliklinikë.

Sistemi i kartelave ICD-10.

Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë dhe siguria e pacientit janë pjesë integrale e aktiviteteve ditore të Spitalit tonë. Në kuadër të objektivave strategjike të Spitalit gjatë viteve të fundit është punuar në mënyrë intensive për përmbushjen e tyre me qëllim akreditimin e institucionit tonë, i cili u realizua në dt. 09.12.2022-09.12.2025.

Menaxhimi i Risqeve dhe Përmirësimi i Cilësisë në Spital

Spitali Rajonal Korçë ka vendosur objektiva të qarta për periudhën në vazhdim. Rritja e sigurisë për realizimin e tyre kërkon një menaxhim efektiv nga ana e stafit drejtues të spitalit. Gjithashtu, kjo i kushtëzon institucionit tonë vendosjen dhe zotërimin e një metode të koordinuar dhe të planifikuar ndaj menaxhimit të rrezikut, identifikimit, analizimit dhe reagimit ndaj rreziqeve me të cilat ballafaqohet veprimtaria e Spitalit .

Spitali Rajonal Korçë e konsideron Menaxhimin e Riskut si balancim të një numri elementesh të ndërthurur, të cilët ndërveprojnë me njëri tjetrin dhe të cilët nëse kërkohet që menaxhimi i riskut të jetë efektiv, duhet të jenë në ekuilibër me njëri tjetrin. Për më tepër, risqe të veçanta nuk mund të adresohen/trajtohen të izoluar nga njëri tjetri, menaxhimi i një risku mund të ketë impakt mbi një risk tjetër apo dhe veprimet e menaxhimit të cilat kanë efekt në kontrollin e më shumë se të një risku të vetëm .

Menaxhimi i riskut është një proces në vazhdimësi i cili duhet të jetë pjesë integrale e procesit të menaxhimit si i tërë dhe është përgjegjësi e të gjithë stafit.

Lidhur me përmirësimin e cilësisë në spital si një grup standartesh me rëndësi në listën e standarteve të akreditimit të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë është parashikuar që , në rregulloret e brendshme të shërbimeve të spitalit përmirësimi i cilësisë të zërë një nen të vetëm si detyrim ndaj stafit të shërbimit me rregulla si më poshtë:

Shefi i shërbimit harton planin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në njësinë që drejton.

Shefi i Shërbimit është përgjegjës për identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarisë së Shërbimit.

Të gjithë punonjësit brenda shërbimit kanë detyrimet si:
Të raportojnë risqet që kanë ndodhur në vendin e tyre të punës tek eprorët e tyre ;
Të paraqesin çdo sugjerim për përmirësimin dhe parandalim të rrezikut;
Të marrin pjesë në monitorimin e vazhdueshëm të rreziqeve dhe të situatave të rrezikshme dhe të raportojnë problemet e zbuluara ;

Personeli shëndetësor ka detyrimin për të qenë i informuar, si një detyrim etik dhe ligjor. Detyrimi për të qenë të informuar ka për qëllim parandalimin e sjelljeve të jashtëligjshme përfshin njohjen e ligjeve, rregulloreve, urdhrave dhe protokolleve të shërbimit shëndetësor.

Çdo mjek duhet të punojë për rritjen e standardeve profesionale dhe të cilësisë së kujdesit shëndetësor si dhe të marrë pjesë rregullisht në programet e Edukimit të Vazhdueshëm Mjekësor;

Shefi i shërbimit harton planin e kualifikimit të personelit në varësi dhe e paraqet në drejtori për aprovim të tematikave në kalendarin vjetor të aktiviteteve. Plani hartohet duke u bazuar në planin e një viti më parë dhe në nevojat aktuale të personelit.

Spitali disponon mekanizma të brendshëm për sigurimin e cilësisë së shërbimeve që ofron, si më poshtë:

Rregullore , protokolle trajtimi si dhe Manual të procedurave brenda spitalit

Ekziston dhe ofrohet mbikëqyrje e brendshme e personelit

Takime periodike ekipore

Mblidhet , dokumentohet dhe raportohet feedback-u për kënaqësinë e klientëve

Aktivitete të edukimit të vazhdueshëm për personelin

Kryhet vlerësimi dhe raportimi vjetor i Treguesve të Performancës Spitalore

Raportimi i incidenteve klinike dhe jo klinike në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Ngritja dhe funksionimi i Komisionit të Menaxhimit të Riskut

Hartimi i platformes së riskut

Hartimi i Manualit të Menaxhimit të riskut si dhe regjistrin e riskut

Ngritja e komisionit për procesin e akreditimit të Spitalit

Ngritja e Komitetit për Përmirësimin e Cilësisë në Spital

Hartimi i planeve të përmirësimit të cilësisë në shërbime dhe programit të përmirësimit të vazhdueshëm të Cilësisë së Spitalit;

Caktimi i koordinatorit të Riskut

Ngritjen e Njesisë së Infeksioneve Spitalore

Ngritjen e Komitetit të Kontrollit të Infeksioneve Spitalore.

Zbatimi i planit strategjik

Drejtimit strategjike si dhe përgjegjësitë e Spitalit për arritjen e objektivave :

Objektiv nr. 1 : Rritja e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore për qytetarët;

Stafi drejtues duhet të analizojë dhe të marrë vendime mbi të gjitha çështjet, lidhur me ofrimin e shërbimeve të spitalit, monitorimin dhe promovimin e aksesit në shërbime, për të lehtësuar dhe nxitur zhvillimin dhe zbatimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë. Brenda këtij objekti përfshihen gjithashtu nënobjektivat si më poshtë, me qëllim përmirësimin dhe zgjerimin e proceseve planifikuese në disa drejtime nga ana e organeve vendimmarrëse.

Përmirësimi i infrastrukturës ndërtimore si dhe ofrimi i shërbimit mjekësor përmes aparaturave e paisjeve bashkëkohore;

Proçesimi më i shpejtë i procedurave ,regjistrim, pranim, shërbim shëndetësor, dalje me qëllim garantimin e aksesit të shpejtë dhe cilësor tek shërbimet spitalore ;

Fuqizimi i pacientëve dhe qytetarëve;

Zbatimi i sistemit të referimit në identifikimin, rregjistrimin dhe lëvizjen e pacientit brenda spitalit;

Monitorimi i zbatimit të rregullave të Sistemit të Referimit dhe ndërgjegjësimi i drejtpërdrejtë i popullatës dhe personelit mjekësor për zbatimin e rregullave të Sistemit të Referimit .

Cilësia është prioriteti ynë kryesor dhe për të garantuar ofrimin e shërbimeve cilësore, janë të nevojshme këto aktivitete:

Plotësimi i standardeve të akreditimit për sigurimin e kujdesit cilësor për shëndetin e pacientit;

Planifikimi dhe bashkërendimi i punës me Ministrinë e Shëndetësisë për të mbështetur investimet kapitale

Zhvillimi, adaptimi, monitorimi i udhëzimeve dhe standardeve për shërbimet

Vlerësimi, zgjerimi dhe aplikimi i aktiviteteve të dëshmuara efektive.

Projekte të reja për vitet në vazhdim.

Në planin tonë strategjik pesë vjeçar, gjykojmë se në spital janë të domosdoshëm:

Objektiv nr. 1: *Investimet kapitale si më poshtë:*

Riorganizim i hapësirës së territorit të spitalit ku janë të vendosura godinat e vjetra .

Punimet e ndërtimit të spitalit dhe rikonstruksionit do të konsistojnë në punimet që konsolidojnë apo transformojnë objektet ekzistuese .

Rindërtim i godinës së administratës, morgut të spitalit dhe repartit të dispancerise në hapësirën që zënë godinat e vjetra

Ndërhyrje në sistemin e kanalizimit të ujrave të zeza të Spitalit .

Sistemi i ngrohjes nëpërmjet gazifikimit.

Sistemimi i garazheve për automjetet që janë në përdorim të Spitalit me qëllim përmirësimin e ruajtjes së tyre.

Objektiv nr. 2 ; *Zvogëlimi i sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së parandalueshme.*

Në objektivat strategjike të institucionit duhet dhënë përparësi : Reduktimit të nivelit të vdekshmërisë nga Infarkti Akut i Miokardit (IAM), brenda 24 orëve të para të shtrimit, reduktim i nivelit të vdekshmërisë nga aksidentet vaskulare cerebrale iskemike dhe i nivelit të vdekshmërisë në shërbimin e urgjencës.

Përmes Poliklinikës së Specialiteteve kryhet diagnostikimi i pacientëve që vijnë me rekomandim nga mjeku i familjes apo direkt, ndjekja e sëmundshmërisë kronike si dhe edukimi i pacientëve për problemet shëndetësore dhe uljen e shtrimeve urgjente në raport me ato të planifikuara.

Kontrolli i faktorëve të riskut (duhani, alkooli, të ushqyerit, aktiviteti fizik) që çon në parandalimin e sëmundjeve kardiovaskulare; diabetit etj

Aksesi në diagnozë të hershme dhe trajtimi;

Bashkëpunimi me mjeket paresore për arritjen e këtij objekti.

Zbatimi i dokumentave strategjike kombëtar, për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve jo të transmetueshme

Objektiv nr. 3 : *Reduktimi i vdekshmërisë foshnjore*

Vdekshmëria zvogëlohet më tej për të arritur nivelet europiane, duke adresuar shkaqet kryesore të saj si dhe duke siguruar shërbime më të mira për nënën dhe të porsalindurin.

Dokumenti strategjik i shëndetit seksual dhe riprodhues 2017-2021 parashikon një sërë veprimesh të fokusuar në:

Programin e imunizimit;

Promovimin e praktikave optimale të ushqyerjes së foshjave dhe fëmijëve të vegjël

Mbështetjen për rritjen dhe zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve

Kujdesin prenatal dhe shëndetin mëmësor;

Sigurimin e kujdesit pas lindjes dhe ofrimin e vizitave në shtëpi në përputhje me protokollet kombëtare.

Sigurimin e cilësisë dhe kujdesit shëndetësor holistik për të gjithë fëmijët, me fokus të veçantë në grupet më vulnerabel, duke përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara.

Gjatë vlerësimit të treguesve të vdekshmërisë amtare dhe fëmimore në Spitalin tonë, vitet e fundit vihet re se treguesi i vdekshmërisë amtare ka zbritur në vlerën zero si dhe kemi vdekshmëri të ulët foshnjore. Këta tregues dëshmojnë një cilësi të lartë të shërbimit ku përveç përmirësimit të aksesit ndaj kujdesit antenatal, është përmirësuar dukshëm cilësia e kujdesit shëndetësor si pasojë e disa faktoreve: investimet e vazhdueshme në infrastrukturen mjekësore, përmirësimi i edukimit të brezit të ri të profesionistëve që punojnë në sektorin e shëndetësisë si dhe përditesimi i njohurive dhe kapaciteteve të personelit shëndetësor nepermjet trajnimeve dhe konferencave të akredituara nga Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdimsi, përmirësimit të standardeve të jetesës, rënies së nivelit të fertilitetit, rritjes së arsimit të nënës, etj.

Objektiv nr.4 : *Zhvillimi i burimeve njerëzore*

Aktivitetet që kërkohen:

Përcaktimi i nevojave për të gjitha nivelet e shërbimit për stafin, të kapaciteteve, aftësive teknike dhe detyrave të punës së çdo punonjësi të Spitalit;

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i personelit shëndetësor;

Vlerësimi dhe përmirësimi i mjedisit të punës dhe kushteve të punësimit.

Motivimi i personelit. Formulimi i strategjive për të motivuar dhe mbajtur personelin e aftë.

Objektiv nr. 5 : *Ofrimi i shërbimit shëndetësor me profesionalizem, me drejtësi dhe të disponueshëm , për të përmbushur nevojat e popullatës.*

Nevojat shëndetësore të popullatës plotësohen me anë të riorganizimit të shërbimeve shëndetësore bazuar mbi parimet e barazisë, cilësisë dhe drejtësisë, në përputhje me lëvizjen e popullsisë dhe përdorimin efiënt të burimeve. Në kuadër të këtij objekti synohet :

Rritja e ndjenjës së përgjegjësisë dhe e profesionalizmit në kryerjen e detyrës nga ana e stafit spitalor si pasojë e evidentimit të çdo veprimi brenda sistemit;

Ndarja e përgjegjësisë të secilit segment të zinxhirit të veprimeve;

Rritja e përgjegjshmërisë, performancës dhe transparencës përmes monitorimit të vazhdueshëm

Thjeshtëzimi i proceseve rutinë dhe përmirësimi i rezultateve në punë;

Përmirësimi i menaxhimit klinik përmes zbatimit dhe azhurnimit të protokolleve klinike

Mbështetja e kërkimit mjekësor/klinik sipas standardeve të kohës

Nxitja e etikës dhe vlerave brenda Institucionit Komunikimi efektiv i informacioneve për riskun dhe kontrollin për fushat e duhura të njësisë

Rritja e profesionalizmit të stafit administrativ dhe spitalor:

Specializim dhe trajnim të stafit në mënyrë të vazhdueshme

Objektiv nr.6 : Sigurim i mirëmenaxhimit, integritetit, transparencës dhe aksesit në shërbimet shëndetësore, me mbështetjen e partneritetit llogaridhënës publik-privat dhe modeleve të tjera për mobilizimin e burimeve shtesë për shëndetin.

Në Sektorin e Shëndetësisë partneriteti Publik Privat shtrihet drejt programeve e shërbimeve madhore shëndetësore, si për shembull instrumentat kirurgjikalë; dializa; paketa e trajtimit të SJT; shërbimet laboratorike; mbetjet spitalore etj.

Në Spitalin Rajonal Korçë shërbimet e dhëna me konçesion janë : Dializa, Shërbimi i Lavanderisë, Shërbimi i Sterilizimit dhe Shërbimi i Labororit .

Në shërbimet tona synohet të garantohet mirëmenaxhim dhe transparencë nëpërmjet:

Përmirësimi të punës për mundësimin dhe fuqizimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, për shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave,

Fuqizimit të mekanizmave të Luftës kundër Korrupsionit, për të përmirësuar menaxhimin dhe performancën .

Fuqizimit të sistemit të referimit si një mënyrë efektive për rritjen e eficiencës dhe parandalimin e korrupsionit në sistemin spitalor.

Objektiv nr.7 : Përdorimi i kontrolluar i antibiotikëve në tërësi dhe kontrolli i infeksioneve spitalore.

Aktivitetet që kërkohen:

Kontrolli dhe parandalimi i infeksioneve spitalore,

Hartimi i politikës së përdorimit të antibiotikëve

Zbatimi dhe azhurnimi i protokolleve klinike nga stafi mjekësor

Objektiv nr.8 Përmirësimi i kostos dhe efikasitetit

Aktivitetet që kërkohen:

Planifikim buxhetor i saktë, që i përgjigjet nevojave reale;

Përmirësimi i planifikimit buxhetor për parashikimin e nevojave për medikamente

Menaxhim më i mirë spitalor përmes teknologjisë së informacionit (sistemeve të informacionit):

Statistika të gjeneruara në kohë reale;

Kontroll i saktë i qarkullimit të çdo pacienti e medikamenti;

Objektiv nr.9 Përmirësimi i sistemit të informacionit:

Aktivitetet që kërkohen:

Ngritja e një shërbimi të integruar të informacionit shëndetësor.

Sigurimi i sistemit të mirëfilltë të raportimit për indikatorët.

Unifikim i të dhënave për përmirësimin e procesit klinik dhe organizimin efikas të fluksit të informacionit;

Grumbullimi dhe analiza e të dhënave të shëndetit riprodhues, performancës së shërbimeve të ofruara; rritja e aftësive të personelit që siguron mbledhjen dhe analizën e tyre.

Burimet

Vendim Nr.439, dt 17.5.2017 Per miratimin e strategjisë Kombëtare të Shëndetsisë 2016-2020

Studim nga Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë Korçë

Standartet e miratuara për shërbimet spitalore

www.instat.gov.al-vjetar statistikor

LEGJISLACIONI

Ligji nr. 9106, datë 17.7.2003, “Per sherbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr.7643, datë 2.12.1992, “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror”, i ndryshuar.

Ligji nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

Ligji nr.S025, date 9.11.1995, “per rmbrojtjen nga rezatimet jonizuese”, i ndryshuar.
Ligjinr.8045, datë 7.12.1995, “Për ndërprerjen e shtatzanise”, i ndryshuar.

Ligjinr.7975, datë 26.7.1995, “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, i ndryshuar.

Ligji nr.8528, datë 23.9.1999, “Për nxitjen dhe mbrojtjen e të ushqyerit me gji”, i ndryshuar.

Ligji nr.8615, datë 1.6.2000, “Për urdhrin e mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr.8626, datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar.

Ligji nr.9150, datë 30.10.2003, “Për urdhrin e farmacistëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr.9474, datë 9.2.2006, “Për ratifikimin e konventës në kuadër të OBSH ‘Për kontrollin e duhanit’”.

Ligji nr.9579, datë 11.7.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Shqipërisë dhe shoqatës ndërkombëtare për zhvillim (IDA) për projektin ‘Modernizimin e sistemit shëndetësor’”.

Ligji nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar.

Ligji nr. 9493, datë 13.3.2006, “Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Artigiancassa S.P.A. për financimin e programit, “Për pesë poliklinika në qytetet e Tiranës, Gjirokastrës, Korçës dhe Peshkopisë”.

Ligji nr. 718, datë 19.4.2007, “Për urdhrin e infermierit në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Ligji nr. 9739, datë 21.5.2007, “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ligji nr. 9928, datë 9.6.2008, “Për shërbimin shëndetësor stomatologjik në RSH”, i ndryshuar.

Ligji nr. 9942, datë 26.6.2008, “Për parandalimin e rregullimeve të shkaktuara nga pa mjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut”, i ndryshuar. Ligji nr. 9952, datë 14.7.2008, “Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it”, i ndryshuar.

Ligji nr. 10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik të ndryshuar.

Ligji nr. 121/2016, “në Republikë në Shqipërisë”.

VKM Nr. 419, datë 04.07.2018 “Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe Funksionimit të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 36 datë 27.01.2023 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e spitaleve rajonale, terciare dhe qendrave spitalore rajonale publike”